
**ALBANIAN VIRTUES IN THE PERSPECTIVE OF FAIK KONICA'S NEWSPAPER
"ALBANIA"**

Albnora Musa Bakiu

University of Tetovo, North Macedonia, albnora.musa@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

University of Tetovo, North Macedonia, hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstract: The era of the Albanian National Renaissance occupies a relatively long historical period starting from the 30-40s of the XIX century until the declaration of Albania's Independence in 1912. The Renaissance marked not only the most powerful and organized political movement of Albanians until that time, but also a development in political and cultural thought. The main goal of this movement, with a political, cultural, economic, social content, was to free the country from the Ottoman invaders and unite the Albanian lands all in one, leaving way for the all-round progress of Albania. Considering the fact that Albania was the only country where nothing national was allowed, various patriots took initiatives outside the national territories. The most louder about this commitment was definitely Faik Konica. As a man who wanted to work and contribute, he decided to plan the publication of a periodical containing only stories, poems and historical documents. However, knowing the character of Konica, it was known that the topics would be more comprehensive. Although with many difficulties, he managed to realize his goal of several years, the announcement of a temporary newspaper. He was not the first patriot to deal with the publication of newspapers, as there were many before him who took this step, but without question he will be the first person who did a colossal job in the written press in the most modern sense.

Faik Konica's contribution to the Albanian cause was multidimensional. His most famous product was undoubtedly the newspaper "*Albania*" where the author did not leave political, historical, war, language, education and culture topics untouched, but all this for one goal, the progress and emancipation of the Albanians. From the day that the newspaper saw the light of publication in 1897, it played the primary role to reflect the circumstances in which the Albanians were, who continued to be under the Ottoman occupation for about five centuries.

Faik Konica as a patriot he knew the Albanian customs and respected them. He recommended that a role for the advancement of the Albanian issue is also played by the well-known Albanian families who should work only for the interests of Albania. Faik Konica loved Albania endlessly. He was eager for a prosperous homeland and wanted his nation to be among the most advanced nations as soon as possible. Therefore, in addition to giving advices, he was the one who revealed the national virtues of the Albanians to others. With an exquisite taste, Konica presents the Albanians in the realization of their crafts and reflects in detail all the crafts that the Albanians developed. Crafting weapons, tools, dishes, clothing, etc.

Konica talked about everything related to Albanians, he devoted whole articles to all the virtues including faith, hospitality, bravery, some traditional masters, the way of eating, folk clothes and any other daily issues of Albanians which considered them national assets.

Keywords: Faik Konica, "Albania", newspaper, virtues, etc.

VIRTYTET SHQIPTARE NË OPTIKËN E GAZETËS "ALBANIA" TË FAIK KONICËS

Albnora Musa Bakiu

Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut, albnora.musa@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut, hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstract : Epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare zë një periudhë relativisht të gjatë historike që fillon nga vitet 30-40 të shek.XIX-të e deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912. Rilindja shënoi jo vetëm lëvizjen më të fuqishme dhe më të organizuar politike të shqiptarëve deri në atë kohë, por edhe një zhvillim në mendimin politik dhe kulturor. Synimi kryesor i kësaj lëvizje me një përmbajtje politike, kulturore, ekonomike, shoqërore, ishte të çlironte vendin nga pushtuesit osman dhe të bashkonte trojet shqiptare të gjitha në një, duke i lënë rrugë përparimit të gjithëanshëm të Shqipërisë. Duke marrë parasysh faktin që Shqipëria ishte vendi i vetëm që nuk lejohet asgjë nacionale atdhetarë të ndryshëm morën iniciativa jashtë territoreve kombëtare. Më i zëshmi në lidhje me këtë angazhim ishte padyshim Faik Konica. Si një njeri që dëshironte të punonte dhe të kontribonte ai vendosi që të planifikonte botimin e një reviste periodike që përmbante vetëm tregime, poema dhe dokumenta historike. Mirëpo

duke njohur karakterin e Konicës ishte e ditur që tematikat do të ishin më gjithëpërfshirëse. Ndonëse me vështirësi të shumta, ai arriti që të realizonte synimin e tij disa vjeçar, shpalljen e një të përkohshme. Nuk ishte atdhetari i parë që u morr me botimin e gazetave pasi që kishte shumë para tij që bënë këtë hap por pa diskutim do të jetë ai personi i parë që bëri një punë kolosale në shtypin e shkruar në aspektin më modern.

Kontributi i Faik Konicës në dobi të çështjes shqiptare ishte shumëdimensionale. Produkti i tij më i vyer padiskutim që ishte gazeta “Albania” ku autori nuk la pa prekur tema politike, historike, lufte, gjuhe, arsimit e kulture, por të gjitha këto për një qëllim, përparimin dhe emancipimin e shqiptarëve. Nga dita që gazeta pa dritën e botimit në vitin 1897 ajo luajti rolin parësor për të pasqyruar rrethanat në të cilat ndodheshin shqiptarët, të cilët për rreth pesë shekujsh vazhdonin të ishin nën pushtimin osman.

Faik Konica si atdhetar që ishte i dinte zakonet shqiptare dhe i respektonte ato. Ai porosiste që një rol për avancimin e çështjes shqiptare kanë edhe familjet e njohura shqiptare të cilët duhej të punonin vetëm për interesat e Shqipërisë. Faik Konica e donte Shqipërinë pafundësisht. Ai ishte i etur për një atdhe të lulëzuar dhe e dëshironte sa më parë kombin e tij në rradhët e kombeve më të përparuara. Andaj përveçse jepte porosi ishte vet ai i cili i shpaloste edhe virtetet kombëtare të shqiptarëve para të tjerëve. Me një shije të hollë Konica i paraqet shqiptarët edhe në realizimin e zanateve të tyre dhe i pasqyron me imtësi të gjithë zanatet të cilat i zhvillonin shqiptarët. Punimi i armëve, veglave, enëve, veshjeve etj.

Konica fliste mbi çdo gjë që kishte lidhje me shqiptarët, ai artikuj të tërë u kushtoi të gjitha virtetet duke përfshirë edhe besën, mikëpritjen, trimërinë, disa mjeshtri tradicionale, mënyrën e të ushqyerit, veshjet popullore dhe çdo çështje tjetër të përditshme të shqiptarëve të cilat i konsideronte pasuri kombëtare.

Fjalët kyçe: Faik Konica, “Albania”, revista, virtyte, etj.

1. HYRJJE

Në “Albania-n” e Faik Konicës një vend të rëndësishëm kanë pasur edhe veçoritë etnologjike si pjesë e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve. Trashëgimia kulturore dhe materiale por edhe e veshjeve kombëtare si një vlerë themelore e shoqërisë nuk duhej lënë pas dore, por ajo duhej të kishte vendin e vet të merituar në shoqëri. (Haziri, M. (2022). Pikërisht këtë ka dëshiruar që të dëshmonte edhe Faik Konica i cili i shpaloste çdo gjë që kishte lidhje me shqiptarët qoftë virtyte të mira ose të aspektit negativ. Ai si atdhetar që e donte vendin i dinte të gjitha zakonet shqiptare dhe i respektonte ato, ai revoltonte sa herë dikush kritikonte diçka të tyre. Stilin konician me gjëmba që përdorte për të kritikuar diçka filluan ta përdornin edhe bashkëpunorët e tij të cilët jepnin kundër përgjigje gjithë secilit përfshirë këtu edhe gazetave të cilat shkruanin diçka në lidhje me shqiptarët. Një gjë e tillë ndodhi edhe kur në gazetën “Drita” që botohej në Bullgari në të cilën ishte goditur odshakësia-parësia shqiptare. Kundër këtij artikulli në këtë gazetë kishte dërguar në adresë të “Albania-s” përgjigje Nuri bej Villa nga dera e vjetër e bejve të Frashërve. Ai mes tjerash theksonte që: *“ishte detyrë e odshakësisë e jo e disa lashdanikëve që të bënin thirrje në drejtim të popullit që djemtë dhe vëllezërit shqiptar të rrëmbenin të gjithë bashkë armët, t’i derdheshin armikut në mënyrë direkte, t’i tregonin zjarrin e trimërisë të pa shuar e të hapnin flamurin e lirisë kombëtare”*. Për të realizuar këtë Konica porosiste se duhej ngritur shqiptarët dhe t’i tregonin Perandorisë Osmane se: *“ky krimb ndyti me erën e tij të gjithë kopshtin e qytetëruar të Evropës dhe verbonte nga sytë të gjithë kombet ku ajo vendosej”*. Andaj bëhej thirrje e parreshtur që të zgjoheshin shqiptarët dhe të përpiqeshin vet si luana për lirinë kombëtare në momentin kur fqinjët armiq fshiheshin si lepuj. Për të pasur rezultat e gjithë kjo, Konica theksonte se e gjithë shpresa e shpëtimit, e lirisë së atdheut ishte tek odshakësia.

2. ODSHAKËSIA SI SHTYTË PËR TË KRIJUAR SHTETIN KOMBËTAR

Historia ishte dëshmitare që çdo çështje kryesore kombëtare ishte realizuar nga odshakësia ose nga njerëzit e çmuar, të ndritur të cilët kishin zënë vendin e odshakësisë në vende ku kjo e fundit nuk ishte prezente (Albania, (1902).

Sa i përket odshakësisë kishte edhe kundërpërgjigje ndaj Faik Konicës se nuk duhej t’i jepej shumë rëndësi asaj pasi që ishte odshakësia ajo që shtypte shtresën e varfër të shoqërisë. Mirëpo Konica kundërpërgjigjet duke vënë theksin tek bejlerët e vërtetë ato që punonin për Shqipërinë. Ai theksonte që i njeh mirë edhe odshakët edhe tregtarët edhe harbutët. Nga asnjë palë e kombit shqiptar ai nuk priste diçka por që dëshironte që në një farë mënyre t’i shërbenin interesit të popullit shqiptar. Lidhur me qëndrimin e odshakëve ai mbështeste shumë edhe shtresën tjetër më të varfër si puntorët, fshatarët, shumica e të mjerëve në Shqipëri, shtresën më të ulët pasi ato i përjetonin të gjitha të këqijat (Albania, (1902). Nuk ishte se odshakësia nuk kishte bërë të këqija në masën shqiptare dhe Faik Konica nuk e fshihte një gjë të tillë. Megjithatë, ai theksonte se asesi nuk duhet të anashkalohej edhe aspekti pozitiv për tentativat e bashkimit të popullsisë shqiptare. Iniciativa ishin marrë nga ana e parisë shqiptare bashkë me të krishterët të cilët filluan që të kundërshtonin Stambollin për të mbrojtur lirinë e përbashkët kombëtare. Nuk shkoi shumë kohë dhe odshakësia e kohës ra me ç’rast filloi mjerimi i masës së varfër qofshin ata të krishterë ose myslimane. Kurse udhëheqësia osmane për të forcuar pozitat e saja përsëri ndër shqiptarët filloi që t’i prishte

shtëpitë e vjetra të odshakësive, qofshin ata të vogla ose të mëdha. Prandaj kundër këtyre armiqve që nuk e donin asesi përparimin dhe qytetërimin duhej të ngulitej mendimi se *odshakësia e ngelur do t'ua thenin hundën* (Albania, (1902). Megjithatë shpesh herë edhe vet Faik Konica theksonte se nëse bëhej një paralelizëm mes odshakësisë së vjetër dhe asaj së resë, më parë Shqipëria kishte deri në pesëdhjetë shtëpi bejlerësh të vjetër e disa oxhakë të krishterë që kishin dashurinë e vendit. Ato jetonin në Shqipëri dhe mbanin një vatër rreth së cilës mblidheshin e ngroheshin të varfërit. Ky lloj i odshakësisë ishte shuar dhe të pakta shtëpi të vjetra kishin mbetur. Lidhur me këtë, Konica theksonte: *“Harbutësia i largonte bejët e vërtetë dhe i dërgonte për në Stamboll ndonëse një pjese u vinte edhe mirë ky shërbim që të lëpinin këmbët e anadollakëve, të bënin poshtërsira se sa të jetonin në Shqipëri të varfër por me nder e hije”* (Albania, (1901).

Përveç odshakësisë së vjetër Konica vë në dukje edhe rolin e të rinjve pasi që siç shprehej ai me kalimin e kohës parandjente një Shqipëri të lulëzuar dhe intelektuale. Ku do të vibrojë një rini kureshtarë, e dhënë pas artit, bukurisë, punës; ata shqiptarë të rinj që do dinë të gjykojnë me drejtësi dhe zemërgjërësi përpjekjet e rilindasve, pleksur me dobësi, ngadalësi dhe paaftësi, por me gjithë zemër të çiltra. Besimi tek rinia qëndronte se do të shqyrtoheshin burimet e dokumentacionit dhe të kritikës çka ishte gjuha dhe çka nesër, gjuha ku do të përmbledhin mendimet apo ëndrrat e tyre. Kurse sa i përket rinisë shqiptare të momentit, Konica theksonte se me çka kishte parë ato i kishte mbërthyer një ndjenjë dhe vullnet të domosdoshëm për tu ndjerë të gjallë si komb. Këtë ndjenjë ato dëshironin që t'a përhapnin, t'a zgjasnin e t'a forconin se të dashurit Shqipërinë nuk do të ishte si më parë por do të ishte vullneti për t'u lulëzuar përgjithmonë (Andrea, F. (2016).

Faik Konica e donte Shqipërinë pafundësisht. Ai ishte i etur për një atdhe të lulëzuar dhe e dëshironte sa më parë kombin e tij në rradhët e kombeve më të përparuara. Për këtë arsye ai zbrazej pa mëshirë ndaj atyre që viheshin në krye për ta drejtuar. Ai kritikonte sepse dëshironte që të përshejtohej procesi i përparimit dhe i lulëzimit në një cep të botës ku natyra kishte falur gjithçka: klimë përrallore dhe bukuri të papara me det e male (Konica, F. (2010). Andaj do të kritikonte edhe odshakësinë dhe të rinjtë që do të vendoseshin në krye nëse do të ishte nevoja.

Faik Konica gjatë gjithë veprimtarisë së tij u mundua që atdhetarët e vërtetë të cilët mundoheshin për Shqipërinë autonome të ishin të sinqertë mirëpo kishte raste kur një pjesë e madhe e tyre vetqeverisjen e atdheut nuk e kishin me gjithë zemër. Këtë të vërtetë përpiquej që t'ua nguliste në kokë atyre atdhetarëve të mirfilltë të cilët duke qenë vetë të drejtë i mendonin edhe të tjerë si vetja e tyre. Për të realizuar vepra të mira ai individ që dëshironte të ishte në krye të Shqipërisë duhej që: *“Që t'i digjet zemra për Shqipërinë që të vuaj duke parë gjendjen e kombit të tij dhe të endërrojë për një ditë më të bukur, duhej që së pari ai njeri të ketë qenë idealist i vërtetë”*. Më pas jep edhe sqarimin mbi idealismin ku thekson se ai mund të paraqitet tek njerëzit vetëm nga dy burime: *një nga kultura e lartë dhe nga një vuajtje e madhe e përbrendëshme*. Kurse sa i përket shqiptarëve ai i specifikon vetëm dy kategori të cilët mund të ishin idealist: shqiptarët të cilët ishin të aftë të mendojnë se deri ku është Shqipëria dhe se çfarë mund të ishte ajo, duke ditur fajtorin kryesor për padrejtësinë e gjendjes dhe kërkojnë mënyrën se si ta heqin qafe atë fajtor. Kurse në kategorinë e dytë ishin shqiptarët të cilët brez pas brezi kanë qenë të shtypur dhe vajtojnë për ditë të bukura (Albania, (1907).

Historia e kishte mësuar Faik Konicën që regjimet shkojnë e vijnë ndërsa akti më i lartë mbetet krijimi i shtetit, lidhja në një territor të vetëm e asaj që ishte shpërndarë andej-këtej. Pra, nëse dikush i kishte vjedhur Konicës diçka dhe dikush tjetër i'a kthente, për të nuk kishte rëndësi se kush i'a kthen rëndësi kishte e drejta që vihej në vend (Ikonomi, I. (2017), për këtë arsye ai i kishte analizuar të gjithë shtresat nga odshakësia, të rinjtë, puntorët e kështu me rradhë. Për të nuk kishte rëndësi se kush do vinte në pushtet rëndësi kishte kush do e realizonte qëllimin e Konicës, shtetin e tij.

3. ZANATET E SHQIPTARËVE SI MJESHTRI EUROPIANE

Duke marrë parasysh që veçoritë etnologjike janë objekt trajtimi kryesisht nga etnologët, të cilët duke i paraqitur ato japin informacione të vyeshme mbi këto virtyte. Duke mos përjashtuar asnjë nga këto veçori ato paraqiten si element i rëndësishëm i etnokulturës të çdo populli. Ato përbëjnë dhe përcjellin vlera shpirtërore dhe materiale që të parët e tyre i krijuan dhe pastaj u përcollën ndër brezat pasardhës, duke pësuar edhe ndryshime në varësi të kushteve të jetës në përgjithësi (Xhagolli, A. (2022). Të rëndësishme paraqiten edhe zanatet dhe Faik Konica i paraqet me një shije të hollë shqiptarët edhe në realizimin e tyre. Këtu duhet theksuar gjithashtu se trojet shqiptare kanë një trashëgimi shumë të pasur kulturore, trashëgimi të gjallë dhe aktive edhe në kohën e re (Statovci Halimi, D. (2022).

Fakt se koha e re sillte zakone dhe nevoja të tjera. Edhe ndër shqiptarët u pa fryma e ndryshimit të cilët përveç se të merreshin me kultivimin e degëve ekonomike filluan që të vepronin në zanate të ndryshme. Faik Konica arrin që t'i pasqyrojë me imtësi të gjithë zanatet të cilat i zhvillonin shqiptarët. Ndonëse mjeshtria e zanateve të shqiptarëve nuk i arriti ato të Florenzës ose Venedikut ose edhe të ndonjë vendi tjetër në Itali, Konica dëshmonte se në Shqipëria kishte puntorët më të mirë në Ballkan. Me këtë rast, Konica numëron disa armë e vegla siç ishin thika, shpata, piscolla, pallaska, butsela të cilat u përhapën dhe gjenden në disa muze të Europës por që kishin dalë nga dora e

shqiptarëve. Ndonëse në këto punime kishte do tipare të cilat mund të ishin imitim i shtyllës arabe në thika, imitim i diçkaje tjetër në armë nga Venediku ato prap se prapë pasqyronin mjeshtëri pasi që imitonin nga më të mirët e kohës dhe ato i bënin në format më të bukura të mundshme. Aktivitetin e shqiptarëve, Konica e shikonte me sy pozitiv dhe i motivonte ato në shkrimet që i bënte në gazetë. Ai shkruante se: “*Secili shqiptar që mendonte se i shkante për dorë diçka le të fillojë që të veprojë në atë fushë, kush armë, kush enë, kush gjësende zbukurimi*”. Si porosi e Konicës do të ishte edhe që produktet të cilat u nevojiteshin shqiptarëve të bliheshin nga shqiptar të cilët e kultivonin atë degë me ç’rast do të kontribonin në tregtinë shqiptare. Në artikujt e gazetës paraqitet edhe momenti i ndalesës së hovit të kultivimit të këtyre zanateve me hapjen e fabrikave të ndryshme. Si pasojë e kësaj një pjese të madhe nuk përfitonte më asgjë dhe një pjesë tjetër u mbyllën. Duke njohur karakterin shqiptar, Konica na jep të dhëna se kishte edhe nga ato odshakë të cilët më tepër preferonin të vdisnin urie dhe të qëndronin kryelartë duke e ditur se nuk do të hynte njeri në atë dyqan se sa të mbyllej. Kjo nënkuptonte që mjeshtria e shqiptarëve aq e lëvdur dhe e lulëzuar po humbiste në harresë (Albania, (1905). Megjithatë, artizanati i shqiptarëve arriti që të depëronte me punimin e kordhave, sëpatave deri në British Museum në Londër ku u demonstruan dy kordha shumë të bukura të bëra nën etiketën “Albanians words” (Albania, (1904).

Një mjeshtri tjetër që ishte në rënie e sipër në Shqipëri ishte edhe rrobaqepësia. Veshjet e punura nga duart e shqiptarëve ishin një paraqitje shumë domethënëse e kulturës sonë. Ata ruanin trashëgiminë e shumë elementeve kulturore që nga lashtësia e deri në ditët e sotme dhe këtu duke marrë shkas që veshjet tradicionale shqiptare llogariten si më të vjetrat në Europë por edhe më gjërë (Selami, Sh. (2022). Brenda kësaj trashëgimie simbolika e motiveve të aplikuara në artizanatin e shqiptarëve përgjithësisht përveç se tregonte lashtësi dhe bukuria paraqiste edhe strategji artistike dhe unitet ornamental brenda për brenda kulturës shqiptare dhe shumë herë të dallueshme nga kulturat e tjera (Statovci Halimi, D. (2022). Zotësinë e shqiptarëve e paraqiste edhe vet Faik Konica në “*Albania-n*” e tij ku theksonte se këtë zanat shqiptarët e kishin shumë për zemër dhe vetëm përgaditja e tyre kishte arritur të bashkojë arin, mëndafshin duke e zbukuruar e duke i bërë të kapshme për syrin. Gjithësecili mund të pretendonte se mund të bënte qepjen por mjeshtria e shqiptarëve nuk ishte vetëm tek qepja por edhe tek durimi. Konica tregonte se kombinimi i arit dhe mëndafshit nuk ishte fare i lehtë për t’u bërë dhe për t’a realizuar atë duhej një kohë relativisht e gjatë. Përveç tjerave për këtë zanat do duhej të kishe edhe hollësinë e përdorimit të gishtërinjve dhe shije në mendje që atë që e ke menduar ta paraqesësh në rroba. Konica shpalos këtu aftësinë e shqiptarëve për qëndisje. Në këtë artizanat ndër më të kushtueshme rroba të qëndisura ishin veshjet kombëtare dhe një gjë të tillë e kuptojmë edhe nga Lordi Byron i cili kur i shkruante nënës së tij i tregonte se ndër gjërat më të shtrenjta në Shqipëri ishin veshjet kombëtare. Mirëpo Faik Konica vë në dukje këtu dhe një tipar tjetër të shqiptarëve, që ata nuk i kishin me shumë qejf më veshjet e tyre kombëtare. Në Shqipëri kishin filluar të mendonin njerëzit se për t’i pëlqyer veshjet kombëtare do duhej të ishte i prapambetur. Një dimension tjetër në lidhje me këtë çështje na jep Konica kur theksonte se duhej të ishte shumë i ditur për të kuptuar se qytetaria nuk kishte të bëjë me veshjet kombëtare. Kundër këtij fenomeni në hapje Konica shkruante shpesh dhe e kundërshtonte një gjë të tillë kur shikonte se kishte edhe disa shqiptar të cilët për të treguar veten e tyre si të qytetëruar talleshin me veshjet kombëtare. Konica kërkonte që shqiptarët t’i shikonin popujt e tjerë se sa me mburrje i veshnin ato, shembuj merte Skotlandën ku skocezët veshnin veshjet kombëtare në dasma, mbledhje, tubime e ku tu jepej rasti (Albania, (1905).

Zhvillimi historik i çdo populli nënkupton para së gjithash zhvillimin e tij kulturor, të arriturat në fushën e krijtarisë materiale, shoqërore dhe shpirtërore. Kultura në kuptimin e gjërë të saj është rezultat i forcave shpirtërore, i dijes njerëzore, i mjeshtërisë dhe i veprimit koshient (Morina, B. (2022), dhe pikërisht shqiptarët janë reflektuesit e saj më të mirë dhe Konica një dëshmues mjaft i mirë i saj.

4.PËRFUNDIM

Shqiptarët, një nga popujt më të vjetër të Europës me një histori të pasur por edhe me vuajtje nga përmasat më të mëdha. Ajo ka një traditë të gjatë që troket diku thellë në lashtësi dhe mban mbi supë peshën e shekujve dhe të mijëvjeçarëve por e pasur me virtyte që bëjnë krenar çdo shqiptar. Shqiptarët jetën kulturore dhe shpirtërore e kanë më të pasurën në botë. Ajo ka një traditë të gjatë nga lashtësia mijëvjeçare dhe populli shqiptar me një gjenialitet dhe xhelozitë të rrallë e ka kultivuar dhe ruajtur deri në ditët e sotme me të gjithë karakteristikat dhe veçoritë e tyre dhe rol kanë luajtur pikërisht edhe shkrimet e mëparshme që ato të plasohen edhe në ditët e sotme. Për të ndërgjegjësuar shqiptarët mbi këtë fakt Faik Konica në organin e tij të shtypit shkruante pikërisht mbi këto virtyte duke i cilësuar si nga më të rëndësishmet që shqiptarët të rikujtonin se kush ishin dhe se do duhej të zgjoheshin nga gjumi për të kërkuar atë se çka u takon pra shtetin e tyre. Artikujt të shumtë janë shkruar mbi trimërinë, besën, mikpritjen, odshakësinë, veshjet kombëtare, zanatet e çdo gjë tjetër që kishte të bënte me virtytet.

“*Albania*” do të ishte nga ato gazeta që la copëza dëshmie mbi çdo gjë. Një rol të rëndësishëm Faik Konica i vendos familjeve të vjetra shqiptare, paresisë ose odshakësisë të cilët mund të kishin funksion parësor në ecurinë e çështjes shqiptare. Konica mendonte se duke pasur ndikim në elitën shqiptare por edhe tek shtresat e tjera shoqërore

ata mund të ishin motorët kryesore të lëvizjes kombëtare shqiptare. Për të nuk ishte e rëndësishme nëse do të ishte odshakësia e vjetër ose e re për Konicën rëndësi kishte që çështjes shqiptare ti vinte fundi në zgjidhjen e problemit. Në artikujt e gazetës “Albania” me një shije të hollë shqiptarët paraqiten edhe si realizues të mirë të zanateve të ndryshme qofshin ata në krijimin e armëve, enëve, veshjeve dhe çdo gjë tjetër që u shkonte pas dore. Konica tregon interesin e hershëm të tij për traditat popullore e posaçërisht për dy mjeshtri tradicionale si ishin argjendaria dhe qepja e zbukurimi i kostumeve popullore. Sipas mendimit të tij, shqiptarët mund të mburren se kanë pasur sigurisht puntorët më të mirë të argjendit në Ballkan.

Faik Konica, kjo figure e shquar e kultures shqiptare ka merita të padiskutueshme për kontributin që ka sjell në shumë fusha të dijes dhe kontributi i tij për kulturën popullore dhe për traditat vendase i gjejmë qysh në vitet e rinisë së tij dhe shtytja kryesore ishin ndjenjat e tij të tella të dashurisë për vendin e të parëve.

BIBLIOGRAFIA

- Gazeta “Albania”, 1902, G, Kalenduar – Janvier, fq. 8-10.
Gazeta “Albania”, 1902, G, Fruar fq. 57.
Gazeta “Albania”, 1902, G, Prill-Maj, fq.78, 80-81.
Gazeta “Albania”, 1901, kalëndor, nr. 1 fq. 6.
Gazeta “Albania”, 1907, Viti 11, Nr.5, fq. 103.
Gazeta “Albania”, 1905, Viti 9, Nr.6, fq. 122-123.
Gazeta “Albania”, 1904, Viti i 8, Nr. 11. I, fq. 204.
Gazeta “Albania”, 1905, Vit 9, Nr. 7, fq. 141-142.
Andrea, F. (2016). Faik Konica-Përlindësi modern. Tiranë: Zenit, f. 372.
Haziri, M. (2022). Veshjet kombëtare dhe diversiteti i saj. Në Veshja shqiptare e Medvegjës dhe e viseve të tjera shqiptare. Prishtinë: Lena, f. 195.
Ikonomi, I. (2017). Faik Konica Jeta në Uashington. Tiranë: UETPress, f. 258.
Konica, F. (2010). Shqipëria si m’u duk/ Shqipëria kopshit shkëmbor. Tiranë: Reklama, f. 3.
Morina, B. (2022). Disa simbole të kultit të gdhendura në gur në kullat e krahinës së Drenicës. Në Zejtaria dhe tregtia në Luginë të Preshevës dhe në viset shqiptare. Prishtinë: Lena, f. 145.
Statovci Halimi, D. (2022). Simbolika e motiveve në zejtarinë dhe në artizantin shqiptar. Në Zejtaria dhe tregtia në Luginë të Preshevës dhe në viset shqiptare. Prishtinë: Lena, f. 87.
Selami, Sh. (2022). Veshjet shqiptare në rrethin e Tetovës. Në Veshja shqiptare e Medvegjës dhe e viseve të tjera shqiptare. Prishtinë: Lena, f. 67.
Xhagolli, A. (2022). Veshjet popullore në hapsirën folklorike shqiptare. Në Veshja shqiptare e Medvegjës dhe e viseve të tjera shqiptare. Prishtinë: Lena, f. 167.